



DREJTORIA E ARSIMIT

04 Nr 110-25790/19

Datë: 24.6.2019

Mbështetur në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-002, në Ligjin për Arsimin në Komunitet në Republikën e Kosovës nr. 03/L-068 si dhe në UA nr. 22/2013 për numrin maksimal të nxënësve në klasë dhe raportin mësimdhënës-nxënës, Drejtoria e Arsimit shpall:

K O N K U R S

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) NË SHKOLLAT E MESME TË LARTA- NË GJIMNAZIN " LUIGJ GURAKUQI" DHE NË SHMP " FEHMI AGANI " NË KLINË PËR VITIN SHKOLLOR 2019/2020

Konkursi shpallet me këto kushte dhe kriteret:

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2019/20, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë verifikimin e dëftësive në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe shkollë profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)

Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe

Certifikatën e lindjes.

Numri i nxënësve që do pranohen në dy shkollat e mesme të larta në Klinë

Gjimnazi "Luigj Gurakuqi" Klinë

Nr.	Drejtimi	Nr. paraleleve	Nr. nxënës
1	Drejtimi shoqëror-gjuhësor	5	160
2	Drejtimi shkenca natyrore	5	160
Gj	2	10	320

SHMP "Fehmi Agani" Klinë

Komuna	Shkolla	Drejtimi	Profili	Nr.i paral.	Nr.i nxën.	Vit. e shkoll.
Klinë	SH.M.T- "F. Agani"	Makineri	Automekanikë	2	60	2+1
			Instal. Ujësjell. & kanaliz.	1	30	2+1
			Operator i prodhimit	2	60	2+1
			Transport rrugore	1	30	2+1
		Bujqësi	Teknologji ushqimore	1	30	2+1
		Ekonomi	Kontabilitet	1	30	2+1
Kline	SH.M.T- "F. Agani"	Kimi- teknologji	Gjeologji	1	30	2+1
			Minator	1	30	2+1
		Tekstil	Kofekcion	1	30	2+1
		Elektroteknikë	Instalues elektrik	1	30	2+1
			Informatikë	1	30	2+1
			GJITHSEJ- KLINË	13	390	

1. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkolla profesionale për vitin shkollor 2019/2020, bëhet më datën **24,25 dhe 26 qershor 2019** në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora **8.00-16.00**.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën **28.6.2019**. Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej **1.7.2019**.

Shpallja e konkursit plotësues nëse ka vende të lira, në muajin gusht do të bëhet më datën **19.08.2019** dhe do të jetë i hapur me datat **19, 20, dhe 21 gusht 2019**. Shpallja e rezultateve për konkursin plotësues do të bëhet më datën **23.08.2019**.

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda **24 orëve**, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - komisionit për ankesa.

Sqarim: Drejtimet për shkolla janë sipas Kornizës së Kurrikulit të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kritere:

- | | |
|--|---------------|
| 1. Suksesi nga shkollimi i obliguar | (25%) 25 pikë |
| 2. Suksesi nga lëndët prioritare në test | (15%) 15 pikë |
| 3. Numri i pikëve nga testi | (60%) 60 pikë |

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 pikë.

Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesi për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjetësisë është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë 4 (Së pari gjendet mesatarja e lëndëve veç e sec pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve)

Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjetësisë është minimumi 40% i pikëve nga ato lëndë

1. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6,7,8,9) mund t'i fitojë maksimalisht 25 pikë.

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

$$\frac{\text{Suksesi (kl.6 + kl.7 + kl.8 + kl.9)}}{4} \times 5 = 25$$

2. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 15 pikë (p.sh 3 lëndë të profilit të caktuar shumëzohet me mesataren e notave të kl. 6 – 9 të (5+5+5+5) = 20; 20 : 4 = 5)

$$\frac{\text{mesatarja e lëndës (I)} + \text{mesatarja e lëndës (II)} + \text{mesatarja e lëndës (III)}}{3} \times 3 = 15 \text{ pikë}$$

Kur në profilin e caktuar kërkohen vetëm dy lëndë në këtë rast vlera e fituar pjesëtohet me 2 dhe shumëzohet me 3

$$\frac{\text{mesatarja e lëndës (I)} + \text{mesatarja e lëndës (II)}}{2} \times 3 = 15 \text{ pikë max}$$

Në rast se kemi 5 lëndë prap mblidhen mesataret e 5 lëndëve pjesëtohen me 5 dhe shumëzohen me 3

3. Kriteri i suksesit të notave në lëndët prioritare për drejtimet përkatëse:

- **Gjimnazi i shkencave natyrore** - Mesatarja e lëndëve: fizikë, kimi, biologji të paku duhet të jetë 4 (katër), si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (10 pikë nga lëndet fizikë, kimi dhe biologji), ky kriter vlen edhe për të gjitha profilet e shkollës së mjeshtësisë
- p.sh për tri lëndë:
$$\frac{Kimi (3) + Biologji (4) + Fizikë (5)}{3} = \frac{3+4+5}{3} = \frac{12}{3} = 4$$
- **Gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore** - Mesatarja e lëndëve: gjuhë shqipe, gjuhë angleze, histori, gjeografi, edukatë qytetare së paku duhet të jetë 4 (katër) si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (20 pikë nga lëndet gjuhë shqipe, gjuhë angleze, histori dhe gjeografi)

p.sh për pesë lëndë:
$$\frac{mes.gj. amtare + mes.gj. ang + mes.his + mes.gjeo + mes.ed. qytet}{5} \times 2 = 15 \text{ max}$$

B. Përmbajtja e testit – numri i kërkesave (pyetjeve) sipas lëndëve:

I. Gjimnazi i gjuhëve

1. Gjuhë shqipe 20 pikë
2. Gjuhë angleze 5 pikë (Gjithsej 25 pikë)

II. Shkencat shoqërore:

1. Gjeografi 12 pikë
 2. Histori 13 pikë
- (Gjithsej 25 pikë)

III. Matematikë

1. Matematikë 20 pikë
 2. informatikë 5 pikë
- (Gjithsej 25 pikë)

IV. Shkencat natyrore:

1. Fizikë 9 pikë
2. Kimi 8 pikë
3. Biologji 8 pikë (Gjithsej 25 pikë)

4. Renditja e lëndëve me prioritet sipas drejtimeve të gjimnazeve:

I. Gjimnazi shkencat e natyrës:

1. Shkencat e natyrës 25 $25 \times 1.2 = 30 \text{ pikë}$
 2. Matematikë dhe Informatikë 25 $25 \times 0.6 = 15 \text{ pikë}$
 3. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 $25 \times 0.4 = 10 \text{ pikë}$
 4. Shkencat shoqërore 25 $25 \times 0.2 = 5 \text{ pikë}$
- Totali = 60 pikë

II. Gjimnazi shoqëror dhe gjuhësor:

1. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze dhe shkenca shoqërore 50 $50 \times 0.9 = 45 \text{ pikë}$
 2. Matematikë dhe Informatikë 25 $25 \times 0.4 = 10 \text{ pikë}$
 3. Shkenca natyrore 25 $25 \times 0.2 = 5 \text{ pikë}$
- Totali = 60 pikë

I. Renditja e lëndëve me prioritet sipas profileve në shkolla profesionale
Shëndetësi, Bujqësi dhe Veterinari

- | | |
|--------------------------------------|---------------------------|
| 1. Shkencat natyrore 25 | $25 \times 1.2 = 30$ pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 | $25 \times 0.6 = 15$ pikë |
| 3. Matematikë dhe Informatikë 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 4. Shkencat shoqërore 25 | $25 \times 0.2 = 5$ pikë |

Totali = 60 pikë

II. Makineri, Elektroteknikë, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë dhe Komunikacion, Kimi – Teknologji

- | | |
|--------------------------------------|---------------------------|
| 1. Matematikë dhe Informatikë 25 | $25 \times 1.2 = 30$ pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 | $25 \times 0.6 = 15$ pikë |
| 3. Shkenca natyrore 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 4. Shkenca shoqërore 25 | $25 \times 0.2 = 5$ pikë |

Totali = 60 pikë

III. Ekonomi

- | | |
|--------------------------------------|---------------------------|
| 1. Matematikë dhe informatikë 25 | $25 \times 1.2 = 30$ pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 | $25 \times 0.6 = 15$ pikë |
| 3. Shkenca shoqërore 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 4. Shkencat natyrore 25 | $25 \times 0.2 = 5$ pikë |

Totali = 60 pikë

IV. Juridik

- | | |
|--------------------------------------|---------------------------|
| 1. Shkencat shoqërore 25 | $25 \times 1.2 = 30$ pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 | $25 \times 0.6 = 15$ pikë |
| 3. Matematikë dhe Informatikë 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 4. Shkenca natyrore 25 | $25 \times 0.2 = 5$ pikë |

Totali = 60 pikë

V. Tregti, Hotelieri dhe Turizëm

- | | |
|--------------------------------------|---------------------------|
| 1. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 | $25 \times 1.2 = 30$ pikë |
| 2. Shkenca shoqërore 25 | $25 \times 0.6 = 15$ pikë |
| 3. Matematikë dhe Informatikë 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 4. Shkenca natyrore 25 | $25 \times 0.2 = 5$ pikë |

Totali = 60 pikë

VI. Shkollat Artistike

- | | |
|--------------------------------------|---------------------------|
| 1. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 | $25 \times 1.2 = 30$ pikë |
| 2. Shkenca shoqërore 25 | $25 \times 0.6 = 15$ pikë |
| 3. Matematikë dhe Informatikë 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 4. Shkenca natyrore 25 | $25 \times 0.2 = 5$ pikë |

Totali = 60 pikë

VII. Kriteret specifike për regjistrimin në shkolla të muzikës

a. Drejtimi pedagogjik – profili bashkëpunëtor muzikor:

Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe testin kombëtar;

b. Drejtimi instrumental:

Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe shkollën e ulët të muzikës (kl. I-VI);

c. Në klasën e VII të shkollës së muzikës mund të regjistrohen vetëm nxënësit që kanë përfunduar shkollën e ulët të muzikës (kl. I-VI).

e. Të gjithë nxënësit që do të regjistrohen në klasën e dhjetë – duhet t'i nënshtrohen provimit pranës nga komisioni i shkollës

DREJTORI FDKA-së
Arben Limanaj

